



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 15.05.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. të prot.DPKI-3006/25/A për zyrtarin lartë Armend Hysa, Sekretari i Përgjithshëm në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë Armend Hysa, Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një raportim nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit, pjesë nga kërkesa (citojmë): "[...] Sekretari i Përgjithshëm i UShAF-it, pas pranimit të raportimit të brendshme nga ana ime me datë 06.03.2025, që kishin të bëjnë me raportimin e shkeljeve të Kodit të Etikës në UShAF nga ana e tij, përveç se ka penguar shqyrtimin e këtyre "sinjalizimeve" raportimeve në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit e Zyrtarit për Protokoll dhe Arkiv, të cilat ai i ushtron dhe menaxhon, si dhe në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve në UShAF, i njëjti ka ndërmarr veprime për shqiptimin e masave ndëshkuese ndaj meje, duke dorëzuar Fletëparaqitje Disiplinore tek Komisioni Disiplinor, të emëruar po nga i njëjti, me anëtar që janë përfshirë drejtpërdrejt në shqyrtimin e sinjalizimeve të mia të brendshme. Ky veprim krijon një konflikt të qartë interesi, duke cenuar paanshmërinë e procedurës disiplinore dhe duke rrezikuar të drejtën time për trajtim të drejtë dhe transparent.

Kërkesa e brendshme ne UShAF për parandalimin e Konfliktit të interesit, për ndryshimin e përbërjes së anëtareve të Komisionit Disiplinor, në të cilin Sekretari më kishte emëruar edhe mua si anëtare, kam kërkuar me email me datat 01.09.2025 dhe 22.09.2025. Siç vërehet, në atë përbërje jam zëvendësuar vetëm unë [...]”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore të parapara sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me pretendimet e ngritura ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të raportimit lidhur me pretendimet e ngritura të situatës së mundshme të konfliktit të interesit, është mbajtur takim me raportuesin e rastit. Në kuadër të këtij takimi, raportuesi ka paraqitur pretendimet dhe qëndrimet lidhur me çështjen në fjalë, të cilat i ka dorëzuar edhe në formë të shkruar, duke theksuar: “[...]Pretendimi bazohet në faktin se ndaj anëtarëve të Komisionit Disiplinor, z. Lavdim Bajrami (kryetar) dhe znj. Leonora Sylejmani (anëtare), kam paraqitur paraprakisht raportime dhe sinjalizime të brendshme për veprime të dyshuara si të parregullta, të dorëzuara pranë z. Armend Hysa, i cili njëkohësisht është zyrtar përgjegjës për trajtimin e sinjalizimeve të brendshme në UShAF. Në këtë kontekst, znj. Leonora Sylejmani e përfshiu z. Armend Hysa në veprimet e raportuara, por pretendimet në raportimet e mia të brendshme nuk u refuzuan dhe as nuk u trajtuan nga z. Armend Hysa. Më pas, të njëjtit persona, z. Lavdim Bajrami dhe znj. Leonora Sylejmani, u emëruan anëtarë të Komisionit Disiplinor që do të shqyrtonte çështjen time. Përkundër kërkesave të mia për ndryshimin e përbërjes së Komisionit Disiplinor, procedura vazhdoi me të njëjtët anëtarë, të cilët ishin subjekt i drejtpërdrejtë i sinjalizimeve paraprake dhe kishin interes personal në rezultatin e trajtimit të çështjeve të raportimeve, duke krijuar situatë të konfliktit të interesit dhe duke cenuar parimin e paanshmërisë dhe objektivitetit procedural[...]”.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe duke u bazuar në pretendimet e ngritura për konflikt të interesit, Agjencia sipas procedurës përmes shkresës zyrtare (DPKI-367/26), e ka njoftuar zyrtarin e lartë Armend Hysa, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në kuadër të zhvillimit të veprimeve procedurale është mbajtur takim me zyrtarin e lartë Armend Hysa, me ç’ rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e ngritura të raportuesit për konflikt të mundshëm të interesit. Gjatë takimit, ai ka paraqitur argumentet dhe sqarimet e tij lidhur me rastin në fjalë, të cilat më pas i ka përcjellë edhe në formë të shkruar në Agjenci.

Nga deklaratat në takim dhe të dërguar përmes shkresës zyrtar (DPKI-453/26) në Agjenci, zyrtari i lartë Armend Hysa subjekt i trajtimit për konflikt të interesit, lidhur me çështjen e ngritur për konflikt të interesit ndër të tjera ka deklaruar (*citojmë pjesë relevante nga deklarata*): “[...]Zyrtarja Rreba Selimi ka thënë se për shkak se ajo ka bërë sinjalizime ndaj meje kinse unë kam ndër marr veprime të padrejta ndaj saj. Kjo nuk qëndron pas s’ka pasur asnjë procedurë sinjalizim dhe deklaroj se ndaj zyrtares së njëjtë nuk kam as nuk kam pasur kurrë ndonjë raport armiqësor përkundrazi nga pranimi i saj më punë në vitin 2019 dhe pastaj

nga avancimi i saj në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore unë kam qenë suporti i saj dhe të tjerëve pasi jam në institucion që afër 20 vite në administratë dhe përvoja ime, përgatitja ime profesionale ma mundëson që të jap suportin tim në të gjitha segmentet e administratës. Kurrë nuk jam kursyer ta ndihmoj zyrtaren Lendita Rreba Selimi në aspektin administrativ ku e njëjta për çdo proces që ka qenë në kompetencat e saja ka kërkuar këshilla administrative dhe kam qenë në dispozicion gjithmonë. Ndaj zyrtares në fjalë kam marrë veprime administrative dhe ligjore që më takojnë si udhëheqës për shkak se e njëjta ka refuzuar detyrat që ja ka përcaktuar ligji dhe aktet nënligjore si udhëheqëse e njësisë së burimeve njerëzore. Vlen të theksohet se zyrtarja në fjalë bazuar në rregulloren për përvojën e punës, e cila ka hyrë në fuqi ka ardhur te unë dhe në prezencë të prorektorit për financa dhe ZKF ka kërkuar që lista e pagave dhe ndryshimet në listën e pagave i takojnë asaj. Pas kësaj e kam autorizuar të njëjtën si zyrtare autorizuese në formularin standard të Thesarit pasi ashtu e kërkon Thesar dhe qëllimi i këtij formulari është se deponohet nënshkrimi dhe Thesari i Kosovës ka mbulesë se i njëjti zyrtar ka të drejtë të nënshkruaj ndryshimet në paga. Nga maji 2023 zyrtarja Rreba ka kryer këtë detyrë dhe kemi e malin ku ka pranuar se kjo është detyrë e saj dhe ka vazhduar deri në muajin tetor 2024, dhe pastaj deklaroi se nuk jep pëlqimin për të kryer këto detyra. Në këtë rast i kam bërë të qartë se këtu nuk bëhet fjalë për pëlqim apo jo, pasi këto detyra janë të rregulluar me akte kolektive ligjore dhe me rregulloret e Qeverisë dhe çdo i punësuar në institucione publike edhe me ligj edhe me kontratë është i obliguar t'i bindet akteve kolektive të Qeverisë. [...] Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se zyrtarja Lendita Rreba Selimi për të shmangur përgjegjësitë saj për rregullimin e ndryshimit në paga vazhdon duke me bërë përgjegjës për të gjitha punët në UShAF si ato të angazhimit të stafit akademik, të cilat janë kompetencën e dekanëve të fakultetit dhe senatit, si organe përgjegjëse për mësim dhe staf akademik ku Sekretari nuk ka as me të voglën përgjegjësi në këtë drejtim si dhe këto mos kompetenca të mija në çështjet akademike i raporton si keqpërdorim të detyrës zyrtare në Këshillin Drejtues dhe kërkon nga Këshilli i Etikës që të formojë komision disiplinor ad hoc, kinse kam shkelur kodin e etik, duke me akuzuar për kompetencat e një organi tjetër ku dihet me Statut dhe Ligjin për Arsimin e lartë, se Senati është përgjegjës për stafin akademik dhe dekanët janë përgjegjës për mbajtjen ose jo të mësimin e jo Sekretari. [...] Veprimet të cilat i kam marrë ndaj zyrtares në fjalë si paralajmërimi verbal dhe vërejtjet me shkrim, pastaj fletëparaqitja disiplinore në komisionin disiplinor janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi duke u gjendur në një situatë ku e njëjta kishte refuzuar kryerjen e detyrave zyrtare dhe nëse nuk i kisha ndërhyrë do të bëja shkele ligjore që do të kishin pasoja për universitetin. Antagonizmi më i madh në këtë çështje është se Lendita Rreba Selimi e respekton një nen të Rregullores nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën e Punës për të punësuarit në Sektorin publik. Për njohjen e përvojës së stafit e respekton nenin 6 por nuk e respekton paragrafin 10 të nenit 5 të po kësaj Rregullore për dërgimin e ndryshimeve në listën e pagave në Thesar. Si mund që një Rregullore të respektohet një nen dhe neni tjetër jo[...].

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas shqyrtimit dhe trajtimit të deklaratave, dhe me qëllim të sqarimit dhe vërtetimit të plotë dhe të gjithanshëm të pretendimeve të ngritura, ka kërkuar nga zyrtari i lartë Armend Hysa informacion dhe sqarime shtesë lidhur me çështjen e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm në UShAF në Ferizaj.

Në informacionin plotësues (squares) dërguar në Agjenci nga zyrtari i lartë Armend Hysa, theksohet se (citojmë pjesë relevante): [...] Sa i përket angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm të stafit akademik nga universitetet publike të Kosovës, unë edhe në takimin me ju e potencova se për shkak të mungesës së numrit të lejuar për staf në UShAF, angazhimi është bërë me vendim të Senatit të UShAF (Nr.2932/24, datë 27.09.2024), si organ më i lartë në UShAF për çështje akademike bazuar në Ligjin për arsimin e lartë dhe në autonominë akademike që gëzon universiteti siç parashihet në nenin 8 të këtij ligji. Gjithashtu angazhimi dhe kompensimi është bërë bazuar në nenin 8 të Ligjit të pagave si dhe Rregullores për të ardhurave personale në UShAF, të miratuar nga Këshilli Drejtues, si organ më i lartë për çështje financiare dhe infrastrukturore (Nr. Prot: 3043/23, datë 02.11.2023). Gjithashtu angazhimet janë bërë me pëlqimet e autoriteteve kompetente të universiteteve publike në Kosovë (Pajtimi i Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë për angazhim të Prof. Ass. Dr. A.K. në USHAF, me Nr. prot.001/486, datë 24.10.2024;Pëlqimi i Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë për angazhimi e Prof. Asoc. Dr. A.T. në USHAF, Nr. 2840, datë 01.11.2024; Pëlqimi i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimi e Prof. Asoc. Dr. N.B.. në USHAF, Nr. 308/02-237, datë 20.09.2024; Pëlqimi i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimi e Asistent A.B.. në USHAF, Nr. 308/02-224, datë 16.09.2024; Pëlqimi i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimi e Asistent B.M. në USHAF, Nr. 308/02-238, datë 20.09.2024), po ashtu edhe me miratimin e konferencës së rektorëve të universiteteve publike marrë parasysh se të gjitha universitetet publike përjashtojnë Universitetin e Prishtinës jemi të gjitha nën ombrellën institucionale të Ministrisë së Arsimit dhe kompensimi është bërë në nr. e pagave (EM) të Ministrisë të cilat janë në sistemin e pagave të Thesarit. Ne si staf administrativ përfshirë mua dhe zyrtarët tjerë nuk kemi kompetenca që të vendosim për angazhimin e stafit akademik qofte të brendshëm apo të jashtëm. Ajo është kompetencë ekskluzive e Senatit dhe ne nuk mund t'i anashkalojmë vendimet e një organi të tillë[...].

Pas administrimit të provave në dispozicion, përfshirë informatat e pranuar nga raportuesi i rastit, deklaratat dhe sqarimet e dhëna nga zyrtari i lartë Armend Hysa, si dhe dokumentacionin tjetër përcjellës të siguruar gjatë zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ, janë administruar provat si në vijim:

- Masa disiplinore-paralajmërimi verbal i datës 13.01.2025, nr. 82/2025, shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm ndaj Lendita Rreba Selimi, për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave zyrtare lidhur me procedimin e lëndëve në Thesar për ndryshim në listën e pagave;
- Masa disiplinore-vërejte me shkrim, datë 11.03.2025, e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm ndaj Lendita Rreba Selimi, për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave zyrtare lidhur me procedimin e lëndëve në Thesar për ndryshim në listën e pagave;
- Fletëparaqitja me nr. protokolli 677/25 të datës 06.03.2025, nga Lendita Rreba Selimi në Komisionin Disiplinor Ad-hoc të UShAF, për shkelje të parimeve të Kodit të Etikës nga Sekretari i Përgjithshëm;
- Shkresa-sqarimi e datës 04.04.2025, nr. protokolli 677/25, me të cilin është konstatuar se Komisionit Disiplinor Ad-hoc të UShAF nuk është organ kompetent për shqyrtimin e këtyre pretendimeve;

- Raportimi i datës 06.03.2025, nr. protokolli 678/25 nga Lendita Rreba Selimi në Këshillin Drejtues të UShAF, për keqpërdorimi të autorizimit zyrtar nga ana Sekretari i Përgjithshëm në UShAF;
- Shkresa-sqarimi e datës 04.04.2025, nr. protokolli 678/25, me të cilin është konstatuar se bazuar në Statutin e UShAF Këshilli Drejtues nuk është organ kompetent për shqyrtimin e këtyre pretendimeve;
- Vendimi Nr. 2728/25, të datës 27.08.2025, me të cilin Sekretari i Përgjithshëm i UShAF, ka formuar komisionin disiplinor për shqyrtimin e rasteve në procedurë disiplinore për stafin administrativ të UShAF, me mandat dy vjeçar;
- Fletëparaqitja e datës 28.08.2025, nr. 2744/25, nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Komisionit Disiplinor të Administratës së Përgjithshme, për Lendita Rreba Selimi për shkelje të rëndë disiplinore “moskryerje të detyrave të punës”, sipas kontratës dhe akteve nënligjore në fuqi dhe “mosbindje ndaj urdhrave të eprorit”;
- Kërkesa me e-mail e datës 01.09.2025, nga Lendita Rreba Selimi për Sekretarin e Përgjithshëm, lidhur me ndryshimin e përbërjes së komisionit disiplinor për shkak të konfliktit të interesit;
- Vendimi i Komisionit Disiplinor, të datës 20.11.2025, nr. prot.5132/25, me të cilin shqiptohet masa disiplinore ndaj zyrtares Lendita Rreba Selimi, “*Ndalimi i avancimit në kategorinë me të lartë në periudhën prej 5 (pesë) viteve*”, për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave të punës sipas kontratës dhe akteve nënligjore në fuqi dhe mosbindja ndaj urdhrave të eprorit.

Pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave në dispozicion dhe rrethanave faktike të rastit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konstaton se nuk ka prova të mjaftueshëm që argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë Armend Hysa, kjo për faktin se veprimet e inicimit të procedurës disiplinore, ndaj zyrtares Lendita Rreba Selimi janë ndërmarr për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrave zyrtare lidhur me procedimin e ndryshimeve në listën e pagave, dhe nuk ndërlidhen me sinjalizimin apo raportimet e brendshme të datës 06.03.2025, ku procedura disiplinore është zhvilluar pas ndërmarrjes së masës fillestare “paralajmërim verbal” me datë 13.01.2025, dhe më pas është trajtuar për të njëjtën çështje edhe nga Komisioni Disiplinor.

Andaj, duke u bazuar në rrethanat faktike të përmendura konsiderojmë se veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë Armend Hysa, kanë qenë veprime në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare dhe se, në rastin konkret, nuk është konstatuar ekzistenca e ndonjë interesi privat që ka ndikuar në ushtrimin e paanshëm të detyrës zyrtare.

Sipas nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nocioni i konfliktit të interesit, përkufizohet si në vijim:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa në Nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përkufizuar interesi privat i personit zyrtar si në vijim:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij neni me të cilin është përkufizuar personi i afërm si në vijim:

"person i afërm me zyrtaren është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."

Poashtu, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të tij ka përcaktuar edhe nocionin e vendimmarrjes si në vijim:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar, prandaj për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Në këtë mënyrë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe rrethanave konkrete në këtë rast, Agjencia konstatoj se në rastin konkret nuk është dëshmuar se ka ekzistuar interesi privat i zyrtarit të lartë Armend Hysa, prandaj në rastet kur ndonjëri nga kushtet thelbësore të konfliktit të interesit, siç është në këtë rast interesi privat, nuk plotësohen kumulativisht, përjashtohet rrethana e konfliktit të interesit sipas dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Megjithatë, fakti që, në situatën konkrete të referuar në Agjenci, nuk është dëshmuar konflikti i interesit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kjo nuk përjashton detyrimin e zyrtarit të lartë, për të trajtuar kërkesën e zyrtares nga procedura administrative, sipas rregullativës së brendshme të UShAF-së dhe/ose legjislacionit tjetër relevant, veçanërisht Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në vijim: LPPA).

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të

cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës z. Armend Hysa dhe palës/ve tjera procedurale
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës (bartësit të lëndës)

